




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Ref: 1509/1097/BA/dk

VENDIMI I BORDIT PËR ANKESA

në çështjen e Ankesës nga

KOSOVA NET

(“Palë Ankuese”)

I përfaqësuar nga:
Z. Burim Qehaja

kundër vendimit të
Komisionit të Pavarur për Media

(“KPM”)

në Ankesën 2014/196
(Vendimit të KPM-së të datës 28 prill 2015)

Faktet

1. Me vendimin e datës 28 prill 2015 (Ref: 1503/282/LEG/hzg, Komisioni i KPM-së shqiptoj gjobën prej 5,000.00 (pesëmijë) euro kundër Palës Ankuese për shkelje të nenit 2 paragrafit 2.1.3, 2.1.5 si dhe nenin 3, paragrafi 3.2.1 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.
2. Bordi për Ankesa, gjen se KPM me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Palës Ankuese me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, me datën 22 gusht 2014 ka bërë monitorimin e Palës Ankuese në selinë e tij dhe ka gjetur se Palës Ankuese ka transmetuar 48 kanale për të cilat nuk ka deponuar dëshmi në KPM se ka të drejtën e ritransmetimit të tyre. Gjithashtu, Bordi për Ankesa ka gjetur se Pala Ankuese nuk bartë as Kanalin Informues ashtu siç është konstatuar edhe nga ana e KPM-së.
3. Bordi për Ankesa duke u bazuar në raportin e monitorimit të bërë me datën 5 shtator 2014, ka gjetur se KPM përmes një kërkesë ka kërkuar nga Pala Ankuese, që në afat prej pesë (5) ditësh t'i sjellë marrëveshjet valide me të cilat dëshmon se Pala Ankuese ka të drejtën e bartjes së 48 kanaleve.

4. Bordi për Ankesa, me datën 11 shtator 2014, gjen se KPM ka pranuar një përgjigje në mënyrë elektronike nga Pala Ankuese, përmes të cilës pretendon se ka bërë ndërprerjen e bartjes së të kanaleve dhe se ka nisur negocimin për marrjen e pëlqimit për bartjen e tyre.
5. Bordi për Ankesa gjen se KPM me datë 17 shtator 2014, ka bërë edhe një monitorim të kanaleve të bartura nga ana e Palës Ankuese me qëllim të verifikimit të njoftimit të Palës Ankuese nëse ka bërë ndërprerjen e bartjes së kanaleve pa të drejtë autoriale. Pala Ankuese ka vazhduar t'i bartë kanalet për të cilat nuk posedon marrëveshje valide dhe të mos bartë kanal informues, duke vepruar në kundërshtim me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës.
6. Bordi për Ankesa, bazuar në shkeljen e Kushteve dhe Termet e Përgjithshme të Licencës nga ana e Palës Ankuese, gjen se KPM me datën 25 shtator 2014, i ka dërguar Njoftim për Shkelje me të cilin ka kërkuar nga Pala Ankuese të veprojë në pajtueshmëri me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, në të kundërtën KPM do të ndërmarrë masa ligjore ndaj Palës Ankuese.
7. Bordi për Ankesa, ka gjetur se KPM edhe pas Njoftimit për Shkelje të dërguar Palës Ankuese, sërish me datë 28 tetor 2014, ka bërë monitorimin e Palës Ankuese në selinë e tij, ku është gjetur se edhe përkundër Njoftimit për Shkelje, Pala Ankuese vazhdon të veprojë në kundërshtim me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës. Në bazë të raportit të monitorimit është gjetur se Pala Ankuese ka bërë shkelje të nenit 2, paragrafi 2.1.3 dhe 2.1.5 dhe nenit 3, paragrafi 3.2.1 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.
8. Bordi për Ankesa, bazuar në raportin e monitorimit të datës 28 tetor 2014 ka gjetur se Pala Ankuese ka bartë 44 kanale pa të drejtë autoriale: *Rtv 21 Plus, Rtv 21 Popullore, Rtv Junior, Klan Kosova, Alsat M, First Channel, Tv Aldi, Tv Presheva, Peace Tv, Fox, Fox Life, Fox Crime, Travel Channel, Motors Tv, Euroneës, True Christmas, True Movies 2, True Entertainment, True Drama, Flava, Bliss, Scuzz, Chart Shoë Dances, The Vault, Chatr Shoë Tv, Pro Sieben, Kabel Eins, Vox Austria, Rtl Austria, Rtl2 Austria, Super Rtl Austria, Sat 1, Hse24 Extra, Sat 1 Gold, Pro Sieben Max, EM TV, MCJ Mediasa, AS TV, Ordu Atlas TV, Turkien TV, Maxi TV, Gala TV, Yildiz TV, Konya TV, Sun TV dhe Uzay TV.*
9. Bordi për Ankesa bazuar në shkeljet e vazhdueshme të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së nga ana e Palës Ankuese, me datën 10 nëntor 2014, gjen se KPM i ka dërguar Vërejtje Palës Ankuese për shkelje të nenit 2, paragrafi 2.1.3 dhe 2.1.5 dhe nenit 3, paragrafi 3.2.1 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës. Bordi për Ankesa ka gjetur se KPM i ka tërhequr vërejtjen Palës Ankuese se veprimi i mëtutjeshëm në kundërshtim me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së KPM-së do të rezultojë me masa sanksionuese në bazë të nenit 30 të Ligjit të KPM-së
10. Bordi për Ankesa, gjen se KPM edhe pas Vërejtjes së dërguar ka vazhduar me monitorimin e Palës Ankuese, ku bazuar në raportin e monitorimit të datës 5 dhjetor 2014, ka gjetur se Pala Ankuese edhe përkundër Vërejtjes ka vazhduar të veprojë në kundërshtim me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës.

11. Bordi për Ankesa gjen se KPM me datën 15 dhjetor 2014, ka ndërmarr edhe hapin e fundit ndaj Palës Ankuese, duke i dërguar Urdhër për shkeljen të nenit 2, paragrafi 2.1.3 dhe paragrafi 2.1.5 dhe nenit 3, paragrafi 3.2.1 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, duke e urdhëruar që menjëherë të veprojë në pajtueshmëri me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, në të kundërtën KPM në bazë të nenit 30 të Ligjit të KPM-së, do të ndërmarrë masa ligjore ndaj Palës Ankuese.

Vendimi

12. Bordi për Ankesa, pas shqyrtimit të argumenteve të paraqitura nga KPM dhe Pala Ankuese konstatoi se, Vendimi i Komisionit të KPM-së është marr në pajtim me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, Ligjin e KPM-së dhe gjendjen faktike të konstatuar në terren..
13. Bordi për Ankesa duke u bazuar në faktin se KPM ka bërë vlerësim të drejtë të ligjit material, procedural dhe vlerësim të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në pajtim me nenin 36, paragrafi 3, të Ligjit të KPM-së vërteton Vendimin e KPM-së Nr. 2014/196, si të drejt dhe të ligjshëm.

Arsyvetimi

14. Bordi për Ankesa në seancën e mbajtur me datë 27 gusht 2015, ka bërë shqyrtimin dhe analizimin e të gjitha fakteve, shkresave të lëndës përfshirë këtu të gjitha raportet e monitorimit dhe dokumentet tjera relevante si: Njoftimit për Shkelje, Vërejtjen dhe Urdhërin të cilat i janë dërguar Palës Ankuese.
15. Pala Ankuese pretendon se pas marrjes së Vërejtës nga ana e KPM-së ka ndërmarr veprime që të sigurojë të drejta për disa kanale, mirëpo Bordi për Ankesa gjen se KPM pas Vërejtjes dhe Urdhrit ka bërë monitorimin e Palës Ankuese dhe ka gjetur se Pala Ankuese në mënyrë të vazhdueshme ka qenë në shkelje të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, duke mos arritur t'i sigurojë të drejtat për bartjen e kanaleve. Pretendimi i Palës Ankuese se ka ndërmarr veprime përmirësuese, bazuar në raportet e monitorimit, është i pa bazuar.
16. Pala Ankuese gjithashtu pretendon se gjoba është shumë e lartë dhe kërkon që t'i zbritet shuma e dënimit, mirëpo Bordi për Ankesa gjen se KPM, është bazuar në vlerësimin e gjendjes faktike në terren dhe duke marr parasysh natyrën shkeljes dhe gjendjen ekonomike të palas ankuese, ka shqiptuar minimumin e dënimit, për faktin se bartja e kanaleve pa të drejtë autoriale konsiderohet prej shkeljeve të renda dhe se për këtë natyrë të shkeljes parashihet edhe Revokimi i licencës sipas nenit 2, paragrafi 2.1.3 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës i cili përcakton se:

“I licencuari nuk do të ri-transmetojë asnjë program pa marrëveshje valide mbi të drejtën autoriale. Bartja e kanaleve të programeve pa të drejtën autoriale përbën shkelje të rëndë të Kushteve dhe Termeve të Licencës dhe shkeljet e tilla rezultojnë me revokim të Licencës”.

17. Bordi për Ankesa , gjithashtu argumenton se gjoba e shqiptuar është edhe në pajtim të plotë me nenin 30 paragrafi 1 pika 3 të Ligjit të KPM-së i cili parasheh se KPM mund të vendosë gjobë nga shuma njëmijë (1.000) deri në njëqindmijë (100.000) euro.
18. Bordi për Ankesa, bazuar në faktet e lartpërmendura, konstaton se Pala Ankuese ka dështuar që të marrë hap të nevojshëm për të ardhur në pajtueshmëri me Kushtet dhe

Termet e Përgjithshme të Licencës, pasi që ka dështuar të sjell marrëveshjet për të drejtën e ritransmetimit të kanaleve, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 2 paragrafi 2.1.3 dhe 2.1.5, si dhe nenin 3 paragrafi 3.2.1, të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.

Neni 2, paragrafi 2.1.3 i Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës përcakton se:

"I licencuari nuk do të ri-transmetojë asnjë program pa marrëveshje valide mbi të drejtën autoriale. Bartja e kanaleve të programeve pa të drejtën autoriale përbën shkelje të rëndë të Kushteve dhe Termeve të Licencës dhe shkeljet e tilla rezultojnë me revokim të Licencës".

Neni 2, paragrafi 2.1.5 i Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës përcakton se:

"Për çdo ndryshim apo modifikim të listës së programeve, skadimin e afatit të kontratës dhe shtimin e kanaleve të reja, KPM duhet të njoftohet 7 ditë para se të bëhen ndryshimet nga i Licencuari. Kopjet valide të marrëveshjeve për të gjitha programet e reja që konsiderohen pjesë përbërëse e listës së programeve për ritransmetim do t'i dërgohen KPM-së nga ana e operatorit kabllor."

Neni 3, paragrafi 3.2.1 i Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës përcakton:

"I licencuari që ofron shërbime kabllore duhet të ketë një kanal të veçantë përmes së cilit identifikohet dhe njëkohësisht ofron informacione për parapaguesit për çdo ndryshim të mundshëm rreth shërbimeve të programeve përmes kabllor."


19. Bordi për Ankesa, bazuar në nenet e lartpërmendur, ka gjetur se Pala Ankuese: ka bërë bartjen e kanaleve pa të drejtë autoriale, ka bërë ndryshimin dhe modifikimin e listës së kanaleve pa miratim paraprak të KPM-së dhe gjithashtu nuk e ka përdorur kanalën INFO përmes të cilit identifikohet si operatorë kabllor. Bordi për Ankesa, duke u bazuar në faktet dhe nenet e lartpërmendura konsideron se Vendim i Komisionit është vendim i drejtë dhe i ligjshëm, i nxjerr në pajtim të plotë me Ligjin e KPM-së, Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës dhe gjendjen faktike.


Rishikim procedural

20. Vendimet e bordit janë përfundimtare në pajtim me nenin 44.2 të Ligjit për KPM-në.

21. Palët në vendim mund të dorëzojnë kërkesën për rishikim procedural në Gjykatë Supreme të Kosovës në pajtim me ligjin e aplikueshëm.

22. Inicimi i rishikimit procedural nuk përfshijë ndryshimin e vendimeve të Komisionit të KPM-së ashtu siç mbështeten apo modifikohen nga Bordi.


Daut KRASNIQI
Kryetar, Bordi për Ankesa



27.08.2015
data

1097

Lloji i dërgesës
Vista postiljke

Vlera e cekur - Shuma e dërguar
Oznaçona vrednost - posilani iznos

nën numër KOSOVA NET - BURIM QESHADA
pod br.

për P. SHKESH SIKEN DER BEY P.N
za

KAMENICE

(Vendi)
(Mesto)

15.09/15


Postë i nënshkuari deklaroi që dërgesa e cekur (shuma e dërguar) është dorëzuar në rregull (paguar me datë)

Dole potpisani izjaviljuje da je pomenuta pošiljka (posilani iznos) predata uredno (placena dana)

Nënshkrimi i nënpunësit të postës së vendit
Potpis radnika pošte

Vula e postës së vendit
Peçat pošte

Nënshkrimi i marrësit
Potpis primaoca



[Handwritten signature]